

U D H Ë Z I M

P Ë R P Ë R G A T I T J E N

E T E M E S S E D I P L O M E S

P Ë R M B A J T J A

- 1. Hyrje**
- 2. Pergatitja e nje Teme Diplome per Studentet e Programeve te Studimit Master Shkencor**
 - 2.1 Si te zgjedhesh tematiken e temes se diplomes**
 - 2.2 Projektimi i Temes se Diplomes**
 - 2.3 Shqyrtimi i literaturës**
 - 2.4 Organizimi i Temes se Diplomes**
- 3. Pergatitja e nje Teme Diplome per Studentet e Programeve te Studimit Bachelor dhe Master Profesional**
- 4. Shkrimi i Temes se Diplomes**
- 5. Detyrimet administrative**
- 6. Udheheqesi Shkencor dhe Procedura e Mbrojtjes së Temes se Diplomes**

Shtojca 1 : Modeli i kopertinës së punimit (diplomës)

Shtojca 2 : Formulari i vlerësimit të punimit (diplomës) nga udhëheqësi shkencor

Shtojca 3 : Formulari i vlerësimit të punimit (diplomës) nga reçenti

1. Hyrje

Pergatitja dhe mbrojtja e temes se diplomes është faza përfundimtare e studimeve tuaja bachelor apo master dhe ju jep mundësi të tregoni se ju keni fituar aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për të organizuar dhe kryer një projekt kërkimor shkencor ose aplikativ.

Tema ju jep mundesine të tregoni se jeni të kualifikuar: në identifikimin e një fushe/ceshtjeje, ne vendosjen e objektivave; gjetjen, organizimin dhe analizimin në mënyrë kritike të të dhënave përkatëse sekondare dhe literatures; ne zbatimin e një metodologjie të përshtatshme ne nxjerrjen e përfundime; dhe nëse është e përshtatshme, ne dhenien e rekomandimeve përkatëse apo te identifikoni fushe/ceshtje per kërkim të mëtejshem.

Tema e diplomes është një dokument 'formal' dhe ka 'rregulla' që tregojne rrugën qe duhet ndjekur per pergatitjen dhe paraqitjen e saj. Duhet të ketë kapituj që ofrojnë një hyrje, një rishikim literature, një justifikim të të dhënave të përzgjedhura dhe metodologjinë e analizës dhe kerkimit, analizën e të dhënave dhe përfundimisht konkluzionet dhe rekomandimet. Kur tema e diplomes realizohet për një biznes ose për një situatë të aplikuar atehere rekomandimet për veprim duhet te jene pjese e saj.

Tema e diplomes per studentet e programit Master Shkencor ndryshon nga format e tjera të diplomave, per vete faktin se merret me analiza te ceshtjeve/situatave qe kerkojne trajtim shkencor. Ajo kërkon përgjigje, shpjegime, bën krahasime dhe arrin në përgjithësime të cilat zgjerojne/shtojne nivelin e njohurive ne fushen e zgjedhur per te studjuar. Temat e diplomes më të suksesshme janë ato që janë specifike dhe të fokusuara ngushte.

Ky dokument ka për qëllim t'ju udhëzojë gjatë procesit të pergatitjes dhe paraqitjes se temes suaj te diplomes. Duhet ta lexoni këtë udhëzues para se të filloni te shkruani temen tuaj dhe te konsultoheni me të gjatë gjithë procesit.

2. Pergatitja e nje teme diplome per studentet e programeve te studimit Master Shkencor

2.1 Si të zgjedhësh tematikën e temes se diplomes?

Nga leximi dhe studimi i literaturës, njohuritë dhe interesi që ka studenti përcakton qartë **subjektin e kërkimit** që përfaqëson fushën e kërkimit. Fusha duhet të jetë nga tematikat e zhvilluara gjatë programit të lëndëve. Pas subjektit, përcaktohet **qëllimi**. Për të përcaktuar qëllimin, duhet t'i përgjigjeni dy pyetjeve: 1) Cili është interesi juaj personal në këtë fushë (subjekt)? 2. Çfarë synohet të mësohet nga kjo fushë?

Qëllimi duhet materializuar. Kjo nënkupton një punë intensive me literaturën, librat, artikujt, revistat, autorët e ndryshëm, etj që zgjerojnë njohuritë tuaja rreth fushës përkatëse. Duke lexuar në mënyrë kritike rreth kësaj fushe / subjekti, studentit mund t'i lindin mendime të ndryshme që zgjidhen dhe synohen të vërtetohen. Kjo ka të bëjë me hipotezën. **Hipoteza**

përfaqëson një propozim për një dukuri e cila duhet testuar në mënyrë rigoroze për t'u pranuar si e vërtetë. Hipoteza ka të bëjë me atë që kërkon të vërtetosh për qëllimin e zgjedhur.

2.2 Projektimi i Temes se Diplomes

Projektimi i Temes se Diplomes fillon nga përcaktimi i qëllimit. Për të arritur qëllimin, mund të përdoren sugjerimet e autorëve të ndryshëm dhe rishikimi i literaturës. Kjo nënkupton vazhdimin e punës së kryer tashmë nga autorët e tjerë. Rishikimi i kujdesshëm i literaturës është i domosdoshëm sepse ndihmon në kristalizimin e mëtejshëm të qëllimit tuaj.

Qëllimi duhet të përpunohet për t'u zhvilluar në një projekt; ky projekt është një dokument prej dy ose tre faqesh, që përmban:

- Objektivat e punimit, arsyet paraprake të zgjedhjes së tyre dhe një formulim i parë i pyetjeve kërkimore;
- Literaturën e shqyrtuar paraprakisht;
- Mjetet /metodat e kërkimit dhe analizës, që do të përdoren për të arritur objektivat;
- Struktura e temes e ndare në kapituj ose çështjet që do të trajtohen, si dhe pjesët origjinale të punimit;
- Bibliografia paraprake

Struktura e temes është një objekt dinamik. Në fazën fillestare, kur konteksti është më i paqartë, mundëson programim të parë të punës që duhet bërë. Me ecurinë e mëvonshëm të punës, si dhe me pakësimin e paqartësive, kjo struktura do të ndryshohet në mënyrë të pashmangshme dhe çdo ndryshim do të përfshijë, qartësisht, një rishikim në programin e punës. Megjithatë, plani nuk mund të ketë dallime rrënjësore në lidhje me projektin fillestar.

Nga çasti që studenti fillon të punojë me temën e diplomes, ai duhet të marrë të paktën 3 rishikime nga ana e udhëheqësit shkencor.

2.3 Shqyrtimi i literaturës

Si në periudhën parapërgatitore, atë të zgjedhjes së subjektit, përcaktimit të qëllimit dhe formulimit të hipotezës, vazhduar më pas me përgatitjen e projektimit të temes se diplomes dhe deri me fillimin e shkrimit të saj, studenti është vazhdimisht në kërkim të literaturës që lidhet me qëllimin e temes. Në mënyrë të veçantë, studenti duhet të evidentojë autorë me të rejtat që kanë sjellë në këtë subjekt, çfarë i shërben studentit nga këto studime për të avancuar më tej kërkimin e tij dhe ta konsiderojë punimin e tij si pjesë e kontributit të përbashkët për këtë subjekt.

Shqyrtimi i literaturës (libra, artikuj, revista), duhet bërë me synimin e njohjes së rezultateve të deritanishme kërkimore – shkencore të asaj fushe dhe jo si burim për mbushje faqesh të

punimit të vet. Përgatitja e nje teme diploma si nje punim kerkimor është i papajtueshëm me çdo lloj plagjiature, përkthimi apo kopjimi të çfarëdo literature. Studenti duhet të udhëhiqet nga sjellja etike e krijimit të personalitetit të vet dhe nga kërkesat ligjore të mbrojtjes së të drejtës pronësore intelektuale.

2.4 Organizimi i Temes se Diplomes

Tema e Diplomes duhet të prezantojë një strukturë të përgjithshme si më poshtë:

- a. Titulli i temes
- b. Dedikimi dhe / ose mirënjohja (opsionale)
- c. Abstrakti
- d. Shkurtime
- e. Lista e tabelave dhe figurave
- f. Tabela e përmbajtjes
- g. Struktura e temes

a. Titulli i temës

Titulli i temës duhet të jetë i shkurtër dhe i qartë (rekomandim: në parim, jo më i gjatë se 15 fjalë). Ai duhet të përkohë me përmbajtjen e vërtetë të temës. Duhet shmangur fjalët / shprehjet e përgjithshme (abstrakte) dhe duhet të formulohet një titull konkret dhe i posaçëm për fushën e studimit.

b. Dedikimi dhe/ose mirënjohja

Dedikimi është opsional. Dedikimi shkruhet në faqe të veçantë. Falënderimi githashtu është opsional. Nëse shkruhet, duhet të jetë në formën e shkrimit të pjerrët (Italic) me madhësi të shkronjave 12 pt). Vetëm personat e përmendur në vazhdim mund të falënderohen: udhëheqësi i temës; studentët kolegë, të cilët kanë ndihmuar në temë; përkrahësit financiar; si dhe anëtarët e familjes. Falënderimi shkruhet në faqe të veçantë.

c. Abstrakti

Tema e studimit paraqitet përmes një abstrakti i cili paraqet përkufizimin e problemit, pse është i rëndësishëm studimi (në lidhje me diskutimet bashkëkohore në fushën e studimit), cila është hipoteza e përgjithshme, metodat, instrumentet dhe rezultatet e pritshme. Në parim, abstrakti nuk duhet t'i tejkalojë 350 fjalë. Si detyrim ligjor abstrakti duhet shkruar edhe në gjuhën angleze.

d. Shkurtime

Në tekstin e punimit studenti mund të përdorë shkurtime për grupfjalësh që përsëriten shumë herë, që zakonisht janë emra institucionesh apo emertime metodash etj., të cilat duhet të rendis në një faqe të veçantë menjëherë pas faqes së abstraktit.

e. Lista e tabelave dhe figurave

Në punim studenti mund të përdorë tabela apo figura të cilat kanë një numer dhe emërtim të posaçëm. Lista e tyre duhet renditur sipas rradhës kronologjike të përdorimit të tyre në punim në një faqe të veçante pas shkurtimeve të përdorura.

f. Tabela e përmbajtjes

Përmbajtja e “Punimit të pavarur kërkimor” në fillim të punimit do të paraqesë të gjitha çështjet / kapitujt e trajtuar në punim sipas numrit të faqes ku fillon çdo çështje / kapitull.

g. Sruktura e temes

Nje teme diplome per studentet e programeve master shkencor duhet te kete strukturen si me poshte:

- a. Hyrjen
- b. Sfondin teorik (kapitull teorik)
- c. Metodologjinë e përdorur
- d. Analizën dhe rezultatet e punimit
- e. Përfundimet dhe rekomandimet
- f. Referencat
- g. Anekset

E gjithë tema e diplomes organizohet në kapituj ndarja e të cilëve do të varet shumë nga tematika dhe metoda e zgjedhur. Me poshte jepet shkurtimeisht cfare duhet te permbaje secila pjese e struktures te paraqitur me lart.

a. Hyrja

Hyrja duhet të përmbajë elementet bazë që shërbejnë për të kuptuar punimin, madje edhe për ata që nuk kanë kohë për të lexuar atë në tërësinë e saj. Ajo duhet të sqarojë objektivat dhe arsyet që shtrohen për zgjedhjen e tyre, të japë disa shpjegime mbi literaturën përkatëse dhe, në mënyrë të përgjithshme, ndarjen e çështjeve / kapitujve.

Ai që lexon hyrjen, duhet të jetë në gjendje të verifikojë në mënyrë të shpejtë dobinë e objektivave të punimit të çdo çështje / kapitulli. Edhe pse arsyet për zgjedhjen e objektivave

shpesh mund të jenë të dukshme, mund të jetë e dobishme që të përmenden ato për të kuptuar më mirë origjinën e punës së kryer. Këto arsye mund të jenë të lidhura me mungesën e një literature të plotë mbi argumentin ose me boshllëqe konceptuale ekzistuese në teorinë në fjalë; mund të jenë të krijuara për shkak të ngjarjeve të reja institucionale apo ekonomike (kriza e një sektori industrial, të një shoqërie tregtare apo të një zone industriale, prezantimi i një ligji të ri, etj) ose nga rëndësia që mund të marrë një fenomen empiric.

Element tjetër i trajtuar do të ishin supozimet (hipotezat) mbi të cilat zhvillohet qëllimi kryesor i punimit.

b. Sfondi teorik

Një punë kërkimore gjithnjë fillohet prej një baze teorike që është mbizotëruese në një fushë të caktuar shkencore. Këtu është e domosdoshme të paraqiten, krahasohen dhe vlerësohen teoritë më të rëndësishme që lidhen me temën e propozuar. Rekomandohet të përmendet literatura dhe studimet që lidhen me temën të autorëve të tjerë duke u përqendruar kryesisht në rezultatet dhe përfundimet e tyre. Studimet më të reja duhet të vendosen në radhë të parë. Kandidati duhet të bëjë të qartë se çfarë dihet në fushën përkatëse të studimit (në lidhje me temën apo problemin që dëshiron të shtjellojë) dhe çfarë nuk është trajtuar ende në mënyrë sistematike, apo cilat pyetje kanë mbetur pa përgjigje. Një nga kërkesat kryesore të kësaj pjese është përshkrimi i sfondit teorik. Kapitull duhet të përfshijë analizën e literaturës së përzgjedhur, për shembull: një paraqitje të ngjeshur të teorive/autorëve kryesorë dhe të monografive më të rëndësishme shkencore në fushën e caktuar, citime të rëndësishme, etj. Po ashtu, duhet bërë e qartë se pse këto teori janë të rëndësishme dhe të dobishme për studimin konkret.

c. Metodologjia e përdorur

Për të realizuar punimin, në arritjen e rezultateve, rëndësi ka metodologjia e përdorur. Në këtë pjesë të temës studenti paraqet të gjitha detajet që kanë lidhje me metodologjinë e përdorur.

Sipas qëllimit të studimit, studenti përcakton edhe metodologjinë që do të përdorë për të arritur rezultatet nga studimi. Studenti për realizimin e punimit të tij mund të përdorë të dhëna primare apo sekondare, por në TBU nxisim çdo student që për të studjuar një problematikë të caktuar të përdorë të dhëna primare të mbledhura nga grup individesh (kliente, konsumatore, firma, institucione etj) apo të studjoje problematiken e zgjedhur duke përdorur një apo disa raste specifike studimore të bizneseve shqiptare.

Studenti, në varesi të programit të studimit, duhet të përdorë metodat statistikore për përpunimin e të dhënave si metoda grafike, tabelore, indekset, e deri tek metoda më të sofistikuar të statistikës probabilitare dhe ekonometrisë, të cilat janë instrumente dhe mjete në duar të studiuesit për të arritur në konkluzione dhe përfundime.

Në rastet kur tema e studimit kërkon metodologji empirike, në këtë pjesë të punimit duhet të

perfshihen gjithashtu elemente të tilla, si p.sh., një përshkrim të kampionit të përzgjedhur, instrumentet e matjes (variablat), procedurat e mbledhjes së të dhënave, përpunimi statistikor, etj.

d. Analiza dhe rezultatet e punimit

Ky kapitull përmban të gjithë analizen që studenti i ka bërë të dhënave të mbledhura për qëllimin e studimit përshkrimi interpretimin e rezultateve në ballafaqim me sfondin teorik të problemit të studimit. Në çdo rast dhe hap pas hapi studenti nepermjet ketyre analizave teston dhe vërtetëson hipotezave të ngritura nga ana e tij. Kjo pjesë duke qenë puna origjinale e studentit duhet të përbejë edhe pjesën kryesore dhe me të rëndësishme të punimit për nga pesha dhe numri i faqeve.

e. Përfundimet dhe rekomandimet

Përfundimet janë pjesë thelbësore e Temës së Diplomes dhe përfaqësojnë çështjen / kapitullin e fundit si kurorëzim i punës së kryer. Ato nuk janë një përmbledhje e thjeshtë, por përbëjnë momentin e verifikimit të strukturës argumentuese dhe të metodologjisë së përdorur në përpunimin e të dhënave dhe të informacionit. Përfundimet duhet të jenë të qarta dhe koncize. Përfundimet duhet të jenë në përputhje me qëllimin dhe objektivat e përcaktuara më parë.

Në këtë pjesë të punimit studenti, bazuar edhe në përfundimet e studimit të tij, mund të bëjë rekomandime për përmirësime të metejshme të politikave të caktuara nga ana e bizneseve apo institucioneve. Gjithashtu këtu mund të përmenden zhvillimet e mundshme kërkimore që mund të kryhen në të ardhmen në atë fushë studimore, mund të jepet ndonjë rekomandim, si dhe të parashtrihen kufizimet e këtij studimi.

f. Referencat

Burimet e cituara gjatë punimit duhet të renditen në fund të punimit në një listë reference. Nuk duhet të përfshihen librat e përdorur gjatë formimit tuaj të përgjithshëm. Kur krijoni një listë reference, burimet duhet të renditen sipas alfabetit të mbiemrit të autorit. Nëse autori është i panjohur, atëherë përfshini këtë burim në listën alfabetike sipas titullit të burimit, për shembull “Banka e Shqipërisë”.

g. Aneks

Në këtë pjesë të punimit studenti mund të përfshijë materiale që janë përdorur për realizimin e punimit por që nuk mund të jenë pjesë e tekstit bazë të punimit. Shembuj të tilla mund të jenë, pyetësoret, anketat, tabela apo analiza shtese që i kanë shërbyer qëllimit të studimit, etj.. Në çdo rast anekset duhet të identifikohen me një numër apo shkronjë dhe duhet të jepet përshkrimi përkatës për secilin.

3. **Pergatitja e nje Teme Diplome per Studentet e Programeve te Studimit Bachelor dhe Master Profesional**

Per strukturen dhe pergatitjen e temes se diplomes studentet e programeve te studimit bachelor dhe master profesional duhet te ndjekin pergjithesisht (per aq sa ben kuptim) udhezimet e dhena me lart per pergatitjen e temes se diplomes ne rastin e programit master shkencor.

Per sa i perket permbajtjes dhe analizimit te temes ne rastin bachelor dhe master profesional me poshte po japim disa specifika.

a. Pergatitja e temes se diplomes per programet e studimit bachelor

Studentet e programeve bachelor duhet te zgjedhin nje teme me fokus shume te ngushte e cila ka lidhje me profilin e studimeve te tyre. Ata per pergatitjen e temes se tyre duhet te fokusohen kryesisht, por jo vetem, ne:

- Pergatitjen e nje plani biznesi
- Analizen e nje apo disa rasteve studimore ne fushen e biznesit
- Analizimin dhe pergatitjen per mbrojtje nga ana juridike te nje rasti specifik
- Analizen e nje ceshtje specifike (ekonomike dhe/ose juridike sipas profilit te zgjedhur) qe shqeteson nje biznes apo nje kategori bizneses te caktuara

Studentet e programit bachelor, perms temes duhet te demonstrojne nje perdorim sa me te plote te njohurive, metodave dhe instrumenteve te pervetesuara gjate studimeve si dhe praktiken profesionale apo punesimin e tij.

b. Pergatitja e temes se diplomes per programet e studimit master profesional

Studentet e programeve master profesional duhet te zgjedhin gjithashtu nje teme me fokus shume te ngushte e cila ka lidhje me profilin e studimeve te tyre. Ata per pergatitjen e temes se tyre duhet te fokusohen kryesisht, por jo vetem, ne:

- Pergatitjen e nje plani biznesi
- Analizen e nje apo disa rasteve studimore ne fushen e biznesit
- Analizimin dhe pergatitjen per mbrojtje nga ana juridike te nje rasti specifik
- Analizen e nje ceshtje specifike (ekonomike apo juridike sipas profilit te zgjedhur) qe shqeteson nje biznes apo nje kategori bizneses te caktuara

Studentet e programeve master profesional duhet te respektojne me shume kerkesat qe kemi paraqitur me lart per diplomen e master shkencor, per sa i perket paraqitjes se permbledhjes se temes dhe sidomos rekomandive qe mund te japin per permiresimin apo zgjidhjen e

.....

problemit te analizuar.

Gjithashtu studenti i master professional duhet te demostrojne nje shkalle te gjere e te thelle te perdorimit te njohurive, metodave dhe instrumenteve te marra ne lendet master professional dhe ne praktiken profesionale apo punesimin e tij.

4. Shkrimi i Temes se Diplomes

Udhezimet e paraqitura me poshte per shkrimin e temes se diplomes do te vlejne per pergatitjen e temave te diplomave nga studentet e te gjitha programeve te studimit, bachelor, master professional dhe master shkencor.

Në përgatitjen e temes se diplomes forma nuk është më pak e rëndësishme se sa përmbajtja. Prandaj duhet të përdoret një nivel maksimal përkujdesje ndaj gramatikës dhe sintaksës së gjuhës shqipe (psh, nuk pranohet punimi pa përdorimin e shkronjave “ë” dhe “ç”).

Për qartësinë e propozimit, është e këshillueshme të shmangen fjalitë e gjata, përdorimi i tepërt i emrave të përmendur, përdorimi i shpeshtë në tekst i shkronjave të pjerrëta, i shkronjave në të zezë, i llojeve të ndryshme të shkrimeve dhe fjalëve të nënvizuara.

Gjithashtu, nuk këshillohen përdorimi i tepruar i citimeve në tekst. Kur ato janë të nevojshme, do të përfshihen duke i vendosur mes thonjzave. Të gjitha citimeve u kërkohet t’u përcaktohet detyrimisht burimi dhe numri i faqes ose i faqeve ku është marrë citimi.

a. Formatimi i “Punimit të pavarur kërkimor”

“Punimi i pavarur kërkimor” duhet të plotësojë disa rregulla të përgjithshme në shkrim, formatim printim dhe paraqitje. Disa rregulla për përgatitjen e drejtë të faqosjes do të ishin:

Formati i faqes:

Madhësia e faqes: A4 (21 x 297 cm); marzhet 2.5 cm lart dhe poshtë, 3 cm majtas dhe 2.5 cm djathtas; hapësira e rreshtave 1.5.

Lloji i shkrimit:

Lloji i shkrimit i këshillueshëm për tekstin: Times New Roman, madhësia 12, renditja e rreshtave nga të dy anët (*Justify*); lloji i shkrimit i këshillueshëm për shënimet në fund të faqes: Times New Roman, madhësia 9.

Fonti që përdoret për tituj – Calibri Bold 16 pts, shkronja kapitale, me renditje në të djathtë; çdo kapitull fillon në faqe të re me numër tek.

Fonti që përdoret për nëntituj – Calibri Bold 12 pts, shkronja kapitale, me renditje në të majtë.

Fonti që përdoret për emërtim të tabelave, grafikëve dhe figurave – Calibri 10 pts

Formati i faqes së parë:

Duhet të ketë si tregues: Logon TBU, “Kolegji Universitar TBU”, titullin e temës, emrin dhe mbiemrin e studentit, udhëheqësin shkencor dhe vitin akademik (*shiko Shtojca 1*)

Lidhja

Punimi i diplomës duhet të jetë i lidhur, kopertina të jetë e fortë, e trashë dhe me ngjyrë *Orange* (ngjyra e logos së TBU-së).

b. Kufizimet ne numrin e fjaleve

Temat e diploma te pergatitura nga studenti duhet te jene te shkruara qarte dhe te fokusuara rreth problemit qe studjohet. Per te ndihmuar studentet qe te jene sa me konkrete dhe te fokusuar ne shkrimin e temes se tyre, tema e tyre e diplomes do te kete kufizim ne numer fjalesh (faqesh) te percaktuar sipas llojit te programit te studimit si me poshte:

- Per programet Master Shkencor tema e diplomes nuk duhet te kete me shume se 15 000 fjale (rreth jo me shume se 50 faqe) pa perfshire bibliografine dhe anekset.

- Per programet Master Profesional tema e diplomes nuk duhet te kete me shume se 10 000 fjale (rreth jo me shume se 30 faqe) pa perfshire bibliografine dhe anekset.

- Per programet Bachelor tema e diplomes nuk duhet te kete me shume se 8 000 fjale (rreth jo me shume se 28 faqe) pa perfshire bibliografine dhe anekset.

Bibliografia dhe anekset nuk llogariten ne kufizimin e flaleve te dhene me lart sipas llojit te programit te studimit. Llogaritja e perafert ne faqe eshte bere duke marre parasysh kerkesat e llojit te shkrimit, fontit, dhe formatit te faqes te paraqitura me lart.

Tema e diplomes nuk duhet të tejkalojë kufirin e përcaktuar të fjaleve për secilin lloj. Tejkalmimi i kufirit të përcaktuar në këtë udhëzim do të shoqërohet me një zbritje në vleresimim përfundimtar të punimit.

c. Shënimet dhe citimet

Shënimet janë të nevojshme për të identifikuar burimin nga i cili është marrë informacioni përkatës. Ato mund të përdoren për të dhënë sqarime, citime dhe referenca të mëtejshme që, në të kundërt, do të rëndonte shumë tekstin duke rrezikuar humbjen e vëmendjes së lexuesit. Ato ndihmojnë dhe për të dokumentuar seriozitetin e një kërkimi. Është e rëndësishme që ato të vihen menjëherë në tekst, në mënyrë që me kalimin e kohës të mos harrohet nga ku është marrë informacioni. Për të shkruar shënimet e referencës bibliografike në brendësi të temës, do të merren në shqyrtim dy mënyra:

– Shënimet e referencës, *dhe*

– Sistemi autor-të dhëna

Shembujt sipas “Shënimit e referencës”:

Sipas kësaj metode, referimet bëhen me *footnote* në faqen ku duhet vendosur referenca. Këto referime numërohen automatikisht nga programi *word*. Shënimi duhet bërë i formës:

Mishkin, Frederic S, Stanley G Eakins: “Financial Markets and Institutions”, Seventh Edition, faqe... Pearson Education, Inc, 2012, fq 202

Në rastet kur i referohemi veprës së fundit të cituar, kur treguesi i faqeve është i njëjti dhe nuk ekziston mundësi gabimi, atëherë është e mjaftueshme të shënohet vetëm “Po aty”

Shembuj sipas “Sistemi autor-të dhëna”

Sistemi autor - të dhëna është një metodë e rëndësishme e referencës bibliografike që mundëson rikujtimin e drejtpërdrejtë, në brendësi të tekstit, të veprave të cituara, duke shmangur kështu përdorimin e shënimeve bibliografike në fund të faqes. Referencat e literaturës së këtij sistemi bëhen duke specifikuar në kllapa autorin dhe vitin e botimit të çdo veprë. Referencat bibliografike të këtij tipi duhet të futen direkt në tekstin aktual, psh: (Bessis, 2010). Në veçanti, në mungesë të autorëve individualë, duhet të konsiderohen si autorë përshtatësit apo ndonjë institut që publikon shkrimin e cituar.

Në rastin e më shumë veprave të të njëjtit vit, viti duhet ndjekur nga një shkronjë, psh: (Bessis, 2010a). Nëse do t’i referohet një pjesë të caktuar të tekstit, është e mjaftueshme të shtohet numri i faqes ose i faqeve, psh: (Bessis, 2010, fq 251).

5. Detyrimet administrative

Për të fituar të drejtën e mbrojtjes së diplomës studenti duhet:

- të ketë shlyer të gjitha detyrimet e programit të studimit
- të ketë dorëzuar në departamentin përkatës punimin e përgatitur dhe të përfunduar e firmosur edhe nga udhëheqësi shkencor. Dorëzimi bëhet i printuar në 2 (dy) kopje dhe në formë elektronike në afatet e përcaktuara nga departamenti. Ai shoqërohet edhe me vlerësimin e udhëheqësit shkencor **jo më vonë se pesë ditë përpara se të kryhet prezantimi dhe mbrojtja e temës.**

Studenti është përgjegjës për të gjitha formalitetet administrative që kërkohen për dorëzimin e temës. Ai duhet t’i dorëzojë udhëheqësit shkencor një disk CD ose një kopje në format elektronik, ku të përmbahet një skedë e vetme me kopjen përfundimtare të temës, emri i këtij file duhet të jetë si më poshtë :

“Mbiemër Emër_____titulli i temës_____lloji i programit të studimit_____viti i temës”.

Studenti duhet të jetë në dijeni të penalizimit deri në anulim të mbrojtjes së punimit ose vlerësimit negativ të punimit, në rast të gjetjes së përdorimit të materialeve, literaturës dhe dokumenteve të tjera të pa cituara në punim. Komisioni i vlerësimit, stafi akademik dhe strukturat e tjera të TBU janë të papajtueshëm me përdorimin abuziv të literaturës dhe botimeve në përgjithësi.

Studenti është në dijeni të faktit që me mbrojtjen e punimit, të drejtat autoriale të punimit i kalojnë TBU. Studentët kanë të drejtën e autorit për punime të shkruara, ku janë paraqitur rezultatet e kërkimeve të punës së pavarur. TBU ruan të gjitha të drejtat e përdorimit të punimeve të lartpërmendura për qëllime edukativo-arsimore dhe kërkimore.

6. Udhëheqësi shkencor dhe procedura e mbrojtjes së Temes se Diplomes

Drejtuesi (udhëheqësi shkencor) i temes se diplomes mund të jetë: çdo pedagog i TBU-së ose ndonjë person tjetër i përcaktuar rast pas rasti dhe i miratuar nga përgjegjësi i departamentit.

Drejtuesi i punimit të diplomës i miratuar nga përgjegjësi i departamentit perkates ndihmon studentin në të gjitha fazat e përgatitjes së punimit dhe, në përfundim, bën vlerësimin e tij sipas modelit të formularit të vlerësimit bashkëlidhur këtij udhëzimi (shtojca 2).

Pas dorëzimit të punimit në department në afatet e caktuara dhe të vlerësimit të punimit nga drejtuesi, përgjegjësi i departamentit cakton reçentin e punimit i cili e vlerëson atë me shkrim (modeli i formularit bashkëlidhur shtojca 3).

Procedura e mbrojtjes së punimit të diplomës është si vijon:

- Kryetari i Komisionit hap procedurën e mbrojtjes;
- Kandidati prezanton punimin në power point: metodën e studimit, gjetjet përfundimtare dhe rekomandimet.
- Anëtarët e Komisionit i bëjnë pyetje studentit.
- Studenti i përgjigjet pyetjeve. Nëse dëshiron një kohë për t'u menduar për përgjigjet, atij mund t'i jepen deri në 10 minuta.
- Komisioni bën vlerësimin përfundimtar dhe ja njofton studentit duke patur parasysh elementët e mëposhtëm të vlerësimit:

Nr	Treguesit bazë të vlerësimit	Nota
1	Vlerësimi me shkrim i drejtuesit të punimit	
2	Vlerësimi me shkrim i recensentit	
3	Nota mesatare e të gjithë viteve të studimit	
4	Cilësia e prezantimit para komisionit të mbrojtjes	
5	Vlerësimi përfundimtar i komisionit ¹	

¹ Pikat 1 - 4 të kësaj tablele janë orientuese. Vlerësimi përfundimtar (5) bazohet kryesisht në vlerësimin e komisionit.

Shtojca 1

**INSTITUCIONI JO-PUBLIK I ARSIMIT TË LARTË
KOLEGJI UNIVERSITAR “TBU”**

TEMA:

XXXXXXXX XXXXX XXXXXXX XXXXXXXXX
XXXXXXXXXXXXXXXX XXXXXXX XXXXXXXXXXX XX
XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

PUNOI:

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

UDHËHEQËSI SHKENCOR:

XXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXXX

VITI AKADEMIK 20XX-20XX

Shtojca 2

Fakulteti _____

Programi i studimit _____

FORMULAR VLERËSIMI I DREJTUESIT

Për diplomën me temë: _____
 _____ përgatitur nga diplomant / i _____

Në cilësinë e drejtuesit të diplomës të sipërtreguar, në përputhje me rregullat e vlerësimit, me praktikën e përdorur nga Fakulteti si dhe me kriteret e vendosura paraprakisht për t'u respektuar nga studentët që përgatisin dhe mbrojnë diplomën, duke ndjekur dhe drejtuar në vazhdimësi punën dhe përgatitjen e kësaj diplome, bëj këtë vlerësim:

Nr	Rubrikat e vlerësimit	Pikët maksimale të vlerësimit për çdo element	Pikët e dhëna nga drejtuesi
1	Zgjedhja e temës	5	
2	Struktura e punimit	15	
3	Metoda e punës dhe e kërkimit	15	
4	Angazhimi i kandidatit	25	
5	Trajtimi dhe qartësia e të shkruarit	25	
6	Përfundime dhe Rekomandime	10	
7	Vlerësimi i posaçëm i pedagogut	5	
	Gjithsej	100	

Tiranë, më _____

Drejtuesi i punimit të diplomës

(Emër, Mbiemër)

Shtojca 3

Fakulteti _____

Programi i studimit _____

FORMULAR VLERËSIMI I RECENTIT

Për diplomën me temë: _____
përgatitur nga diplomant/e _____

Në cilësinë e reçentit të diplomës të sipërtreguar, në përputhje me rregullat e vlerësimit, me praktikën e përdorur nga Fakulteti si dhe me kriteret e vendosura paraprakisht, duke analizuar përmbajtjen e diplomës, pëfundimet e rekomandimit që jepen në të, e vlerësoj si vijon:

Nr	Rubrikat e vlerësimit	Pikët maksimale të vlerësimit për çdo element	Pikët e dhëna nga reçenti
1	Zgjedhja e temës	5	
2	Struktura e punimit	15	
3	Metoda e punës dhe e kërkimit	20	
4	Trajtimi dhe qartësia e të shkruarit	40	
5	Përfundime dhe Rekomandime	20	
	Gjithsej	100	

Tiranë, më _____

Reçenti

(Emër, Mbiemër)